



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	04.10.2023	17.10.2023	2023/0742

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.09.2023, OE “ISUF MUSLIU B.I.”, ka parashtruar ankesë me nr: **2023/0742**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “Beni Dona Plast”SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Sherbime me ushqim (furnizim, pergatitje dhe servim) per nevoja te PK-se**” me nr. të prokurimit: “**214-23-6749-2-1-1**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **5,500,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankes.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 61 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.01/2022 për Prokurim Publik
Neni 41 i Rregullores Nr.01/2022 për Prokurim Publik

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.03.07.2023, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 04.08.2023.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte bërë me dt. 14.09.2023 ku është rekomanduar për kontratë Beni Dona Plast SH.P.K. me çmim prej:36.26 €, ndërsa neve na ishte dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm.

Ne kemi pasur qasje në dokumentacion, ndërsa gjatë analizimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë kemi vërejtur se ky OE është i papërgjegjshëm për arsyet që do ti elaborojmë më poshtë.

OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta, prandaj është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Çmimet jo normalisht të ulëta për pakot e ofruara janë të elaboruara si më poshtë:

Në pakon **Nr.5** ka ofertuar me çmim prej **4.20 €**, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej **6.94 €**.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për **47%** më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon **Nr.6** ka ofertuar me çmim prej **4.50 €**, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej **7.54 €**.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për **44%** më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues

Në pakon **Nr.7** ka ofertuar me çmim prej **4.75 €**, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej **6.81 €**.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për **42%** më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon **Nr. 8** ka ofertuar me çmim prej **5.90 €**, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej **7.71 €**.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për **33%** më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon **Nr.9** ka ofertuar me çmim prej **4.20 €**, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej **6.41 €**.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për **47%** më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon **Nr.10** ka ofertuar me çmim prej **5.49 €**, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej **7.61 €**.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për **39%** më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.11 ka ofertuar me çmim prej 4.47 €, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 7.51 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 68% më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.12 ka ofertuar me çmim prej 4.65 €, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 6.31 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 36% më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.13 ka ofertuar me çmim prej 5.50 €, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 7.68 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 40 % më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.14 ka ofertuar me çmim prej 4.16 €, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 6.98 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 68% më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.15 ka ofertuar me çmim prej 4.75 €, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 6.88 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 45% më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.16 ka ofertuar me çmim prej 4.76 €, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 7.08 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 48% më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.17 ka ofertuar me çmim prej 4.47 €, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 5.76 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 29% më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.18 ka ofertuar me çmim prej 3.56 €, ndërsa për këtë pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 6.66 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 87% më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Në pakon Nr.19 dhe 20 ka ofertuar me çmim prej 1.70 €, ndërsa për këto pako autoriteti kontraktues ka parashikuar çmimin prej 3.70 €.

Në përqindje kur llogaritet, rezulton se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar për 118% më lirë se sa e ka parashiku autoriteti kontraktues.

Këto dy pozicione i njëjti operator ekonomik para dy viteve i kishte ofertuar me çmime nga 2.89 € për pako (2.89 € për pakon 19 dhe 2.89 € për pakon 20), ndërsa tani pas ngritjes së çmimeve oferton me çmime më të ulëta prej 1.70 €.

Ky është një absurditet dhe një jo seriozitet dhe manipulim nga ana e OE të rekomanduar për kontratë vetëm për të fituar kontratën, prandaj është e pamundur të realizohen këto pako me këto çmime.

Siç dihet vetë autoriteti kontraktues ka bërë parashikimin e çmimeve duke u bazuar në çmime të tregut (madje çmimet e parashikuara nga AK janë edhe më pak se sa vlera reale e tregut), ndërsa vetë ky autoritet nuk i ka marr për bazë parashikimet që janë bazu përafërsisht në çmime të tregut. Ky veprim i autoritetit kontraktues tregon për njëanshmëri dhe favorizim të OE të rekomanduar për kontratë dhe ky veprim bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores Nr.01/2022 për Prokurim Publik sepse nuk ka analizuar çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, madje as nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga ky operator ekonomik.

Neni 61.1 e përcakton qartë: Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë

me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Pra autoriteti kontraktues nuk ka ndjek asnjë procedurë ligjore në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta të ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë.

Siç shihet nga analiza e çmimeve rezulton se për pako të ndryshme ka ofertuar me çmime më të ulëta 118 %, 87%, 68 %, 48 %, 47 %, 45 %, 44% etj.

Është e çuditshme se përse nuk janë kërkuar sqarime dhe nuk janë analizuar çmimet e pakove por në mënyrë të njëanshme autoriteti kontraktues ka favorizuar OE e rekomanduar për kontratë.

Sa duhet të jetë çmimi më i ulët e që për autoritetin kontraktues të konsiderohet çmim jonormalisht i ulët? apo të kërkohen sqarime!

Nuk ka asnjë mundësi praktike e as ligjore që ky Operator ekonomik ta implementojë këtë kontratë me këto çmime.

Është shqetësuese se si autoriteti kontraktues nuk ka shpreh fare vullnet për të analizuar këto çmime por e kanë rekomanduar për kontratë një OE që shihet qartë dhe dukshëm që ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta.

Po ashtu anëtarët e komisionit vlerësues nuk janë asnjëri profesional sa i përket çmimeve dhe përgatitjes së ushqimeve, prandaj edhe raporti i vlerësimit nuk është profesional dhe nuk është dashur të merret parasysh nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.

Komisioni i vlerësimit është dashur të merr parasysh vlerat e parashikuara për pako ushqimore dhe çmimet e ofruara për pako nga OE i rekomanduar për kontratë. Po ashtu është dashur të kenë parasysh edhe çmimet e tregut dhe çmimet e ofruara nga tenderët e kaluar nga ky operator ekonomi dhe të krahasojë me çmimet aktuale.

Vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me dt.19.092023.

Në këtë vendim autoriteti kontraktues vetëm ka përshkruar nenet për të cilat kemi pretenduar se janë shkelur pa i arsyetuar ato.

Në lidhje me çmimet jo normalisht të ulëta, autoriteti kontraktues ka konsideruar se të gjitha çmimet janë çmime të besueshme dhe se nuk ka asnjë çmim që do të ndikonte negativisht në performancë të implementimit të kësaj kontrate.

Autoriteti kontraktues i mbron çmimet sikur të ishte vetë OE i rekomanduar për kontratë apo më mirë të themi mundohet ti arsyetojë edhe më shumë se sa vetë OE i rekomanduar për kontratë.

Si nuk mund të ndikojë negativisht çmimi i cili është ofruar për 118 %, 87 %, 78 % etj., në krahasim me analizën e çmimeve të bëra nga autoritetit kontraktues, e leje më që këto çmime janë edhe më shumë të ulëta (në përqindje) se sa çmimet aktuale të tregut?

Kërkojmë nga eksperti i OSHP-së që të analizojë fillimisht çmimet që i ka nxjerr dhe parashikuar vetë autoriteti kontraktues, më pastaj çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë për pako dhe të analizohen çmimet e tregut për të pasur një pasqyrë të qartë në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë.

Nga ana e autoritetit kontraktues nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në

nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm, që ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Duke pasur parasysh të gjitha arsyet faktike dhe ligjore që u përmendën më lartë, kërkohet nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE “NTP GLOBAL PARAJSA
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në
RIVLERËSIM.

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

KRITERET PËR VLERËSIM

--

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

--

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "ISUF MUSLIU B.I.", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servis) për nevoja të PK-së" me numër të prokurimit: "214-23-6749-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Qeveria – Vlada – Government</p> <p style="text-align: center;">Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave / Ministry of Internal Affairs and Public Administration Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Generalna Policijska Direkcija General Police Directorate</p>	
---	---	--

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES¹

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Titulli i kontratës: Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servis) për nevoja të PK-së

Nr. i Prokurimit:	214-23-6749-2-1-1
Nr i brendshëm	214/ 23/ 074/ 211

Nr.	Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës	Vlera totale e ofertave ² (€)
1	Beni Dona Plast SH.P.K.	36.26 €
2	Grup i Operatorëve Ekonomik N.T.P. ' GLOBAL PARAJSA '; N.H.T. Edukimi	47.91 €

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

Policia e Kosovës për këtë aktivitet të prokurimit, shpërblen me kontratë Beni Dona Plast SH.P.K. në vlerë totale të ofertës me çmim të peshuar për njësi prej 36.26 €.

Data: 12/09/2023.

Emri dhe mbiemri i ZPP: Shumë

B46-Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm⁴

13/09/2023, Prishtinë

POLICIA E KOSOVES, Rr "Luan Haradinaj"- nr. 99 ndërtesa e re e Administratës të Policisë, kati II, zyra e Prokurimit nr. 31, Prishtinë, Kosovë

Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T.P. ' GLOBAL PARAJSA '; N.H.T. Edukimi - Prishtinë

Nr. i Prokurimit:	214-23-6749-2-1-1
Nr i brendshëm	214/ 23/ 074/ 211

Titulli: Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servis) për nevoja të PK-së

I/e nderuar(a) [Z/Znj] – N.T.P. ' GLOBAL PARAJSA '; N.H.T. Edukimi – Prishtinë

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - ISUF MUSLIU B.I.

Aktiviteti i prokurimit: "**Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) për nevoja të PK-se**" me nr. të prokurimit: "214-23-6749-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, ka filluar me publikimin e njoftimit për kontratë me datë 03.07.2023, me procedurë të hapur, hapja e ofertave është bërë me datë 04.08.2023, si dhe vendimi mbi rekomandimin është publikuar me datë 14.09.2023.

OE ankuesi pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 28.09.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, duke pretenduar se OE i rekomanduar nuk i plotëson kriteret, si dhe AK nuk ka vlerësuar ofertat konform nenit 1, 7, 59, 60, 61, 69, të LPP-së si dhe neni 40 dhe 41 i Rregullores nr.01/2022 për Prokurim Publik.

OE ankuesi nga AK është shpallur i pasuksesshëm.

Tutje, i njëjti pretendon se OE i rekomanduar ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta përkatësisht për pakot me nr.5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, dhe 20.

Ekspertja shqyrtuese gjatë analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve të OE

ankuesit, duke i krahasuar me dokumentet në e-prokurim, që të mbetet sa më objektiv, ka kërkuar sqarime me e-mail me datë 12.10.2023 nga OE ankuesi lidhur me dëshmitë dhe faktet.

OE ankuesi ka bashkangjitur në e-mail dëshmitë (listën) për të cilat AK-njësia kërkuese ka parashikuar një çmimore tëpakove, e cila i është dërguar në e-mail ofertuesve si mostër lidhur me parashikimin e çmimeve.

Tutje, ekspertja shqyrtuese duke marrë parasysh dëshmitë dhe faktet e OE ankuesit lidhur me çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar, konsideron se AK duhet të kthejë lëndën në rivlerësim, duke kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar, për faktin se AK ka parashikuar një çmimore për ofertuesit e cila bie ndesh me çmimet e OE të rekomanduarit, dhe si rrjedhojë konform nenit 61 të LPP-së gjegjësisht nenit 41, par:41.6, 41.7, 41.8, 41.9, 41.10, 41.11 të udhëzuesit me nr 002/2023 për prokurim publik, lënda kthehet në rivlerësim dhe rekomandohet AK-në që procesin e rivlerësimit të bëjë konform dispozitave ligjore të LPP-së, udhëzuesit nr 001/2023 për PP si dhe rregullorja nr 002/2023 për PP.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “ISUF MUSLIU B.I.”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime me ushqim (furnizim, përgatitje dhe servim) për nevoja të PK-së” me numër të prokurimit: “214-23-6749-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ISUF MUSLIU B.I.**



Blerina Huruglica